Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 30.12.2021*	*Data e dorëzimit të raportit 10.01.2022*	Nr. i lëndës: *867/21*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.12.2021, grupi i OE **N.N"100% Design"Shpk & K.N.P.SH" Papenburg & Adriani Company"Shpk** – Skenderaj,ka parashtruar ankesë me nr: 867/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE **N.T "Fer - Petorll"&"SH.Drini Company" Shpk -** Gllogoc,lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Sanimit të rrëshqitjes së rrugës në hyrje të Autostradës nga rruga Nacionale N2 në Mazgit (Zona kadastrale-Obiliq) ",me nr.të prokurimit: 205-21-8994-5-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Infrastrukturës".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike,**Punë**,vlera e parashikuar e kontratës: **346,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 6 LPP-së – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
Neni 59 LPP-së – Ekzamnimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 65 LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 66 LPP-së- Përshtatshmëria profesionale

Kompania jone ne baze te ligjit per zgjidhjen prelimininare te mosmarreveshjeve neni 108/A i LPP-së ka paraqitur kerkesen per rishqyrtim ku kemi argumentuar pse vendimi ishte i padrejte nga ana e Autoritetit Kontraktues duke vleresuar se lenda duhet te kthehet ne rivleresim.

Ne mendojme qe kompania jone eshte eliminuar padrejtesisht meqenese oferta jone ka qene me cmimin me te lire duke shkelur keshtu ***Neni 6 LPP-së – Eonomiciteti dhe efikasiteti.***

Autoriteti kontraktues ka bere shkeljen ***e nenit 59 LPP-së – Ekzamnimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve***

duke na eliminuar dhe shpallur fitues nje oferte qe eshte e papergjegjshme.

Ne dosjen e tenderit jane te cekura kerkesat e pershtatshmerise qe fituesi duhet ti kete dhe qe konzorciumi fitues nuk i ka duke shkelur keshtu ***Neni 65 LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve***

Kërkesat e përshtatshmërisë:

a) Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .

b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës

c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës

d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Kompania SH. Drini Company shpk nuk ka sjell nje vertetim nga Administrata Tatimore qe nuk eshte ne vonese per pagesen e tatimeve por ka ofruar nje Vertetim Tatimor te dates 24.08.2021 ku ceket se kompania ne fakt ka borxhe.

Poashtu dokumenti i ofruar i muajit gusht duke qene se jemi ne muajin dhjetor na len te dyshojme qe kompania nuk ka pasur mundesi pas kesaj date te siguroj vertetim fare.

VËRTETIM TATIMOR
TAX VERIFICATION
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:

1000810518

Emri i personit: Name of Person: Ime lice:	SH. Drini Company SH.P.K.
Numri Identifikues Personal: Personal Identification Number: Identifikacioni Lični Broj:	1007985572
Numri Fiskal: Fiscal Number: Fiskalni Broj:	810608333
Komuna: Municipality: Opština:	PRIZREN
Data: Date: Datum:	24.08.2021
Arsyeja e lëshimit: Reasoning: Razlog izdavanja:	Aplikim për Tender

ka këtë gjendje tatimore në ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura
This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy outstanding tax debts
Lice je registrovana u PAK i aktuelno je u sporazumu u ratama za isplatu ostalih poreskih dugova

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk

Sa i perket pikes d) te kerkeses se pershtatshmerise ku kerkohet qarte nje vertetim nga Gjykata qe drejtuesit e kompanive **NUK JANE SHPALLUR FAJTOR** per kryerjen e nje vepre **PENALE** ose **CIVILE** duke i perfshire praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhenien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjajshme.

Kompania Fer Petrol ka te regjistruar si pronar z. Mehdi Gjoka sic shihet ne certifikaten e biznesit per te cilin ka nuk ka arritur te permbush kerkesen e cekur me larte.

Pronarët / Owners / Vlasnici

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Mehdi Gjoka
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1015546227
Adresa: Address: Adresa:	Tërstenik Tërstenik Gllogoc, Kosova
Përgjegjësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesa në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	€
Data: Date: Datum:	02/02/1978

Kompania ka ofruar nje sqarim per kete lende duke u deklaruar se lenda ne fjale nuk ka te beje me qeshtjet te cilat jane te cekura ne piken d)

Rikujtojme qe pika d) nuk kufizohet vetem ne korrupsion, larjen e parave dhenien e mitos apo anvantazhe ose aktivitete te ngjajshme. Pika d) e pershtatshmerise fillimisht kerkon qe te mos kete denime ne dhjete vitet e fundit ne vepra PENALE ose CIVILE ndersa certifikata nga gjykata e deshmon qe **z.Mehdi Gjoka eshte i denuar me Aktgjykim te formes se prere**.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË GJILOGOC
OSNOVNI SUD - OGRANAK

Me kërkesë të MEHDI FERAT GJOKA, Nr.personal 1015546227, i lindur me 02.02.1978,
Na zahtev, Lični Br., Datum rođenja

në TËRSTENIK KK GJILOGOC, me vendbanim në TËRSTENIK, lëshon këtë:
u, se prebivalištem u, izdaje ovu:

CERTIFIKATË

NGA EVIDENCA E PERSONAVE KUNDËR TË CILËVE ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURA PENALE DHE PERSONAVE TË DËNUAR NGA KJO GJYKATË

UVERENJE

IZ EVIDENCIJE LICA PROTIV KOJIH SE VODI KRIVIČNI POSTUPAK I OSUĐENIH LICA OD OVOG SUDA

Ate të cilën konfirmon se kundër parashtruesit të kërkesës, si person fizik MEHDI GJOKA
Ovjom se potvrđuje da se protiv podnosioca zahtjeva, kao fizičkog lica

Ate të cilën konfirmon se kundër parashtruesit të kërkesës, si person juridik
Ovjom se potvrđuje da se protiv podnosioca zahtjeva, kao pravnog lica

- Nuk është duke u zhvilluar procedurë penale. ☐
  Ne vodi krivični postupak.
- Është duke u zhvilluar procedura penale sipas lëndës P.nr. 600/16
  Vodi krivični postupak po predmetu K.br.

  për veprën penale/*za krivično delo*

  nga neni/ *iz člana* I KPRK –së/ *KZRK-a*
- Nuk është i dënuar. ☐
  Nije kažnjen.
- Është dënuar me Aktgjykim të formës së prerë nr./*Kažnjen je pravosnažnom presudom br.* 600/16,

  datë/*dana*, me dënim/ *kaznom*, në kohëzgjatje prej/ *u trajanju od*

  , ose gjobë në shumë prej/ *ili novčanom kaznom u visini od*

Dënimi i shqiptuar është ekzekutuar ☐, është ne fazën e ekzekutimit ☐, nuk është ekzekutuar ende ☐.
Izrečena kazna je izvršena, nalazi se u fazi izvršenja, nije izvršena.

Arsyetim
I LARTPERMENDURI ËSHT I DENUAR ME DËNIM TE KUSHTËZUAR 6 MUAJ PER 1 VIT DT E PLOTFUQISHMERIS 10.03.2020
Imedba

Ky Certifikatë mund të përdoret për: TENDER.
Ovo Uverenje se može koristiti u svrhu

Nr. NR/KR.Br 5460/2021

Data/Datum 06.12.2021

REFERENTI: HAMZE ISUFI

Referenti/Službenik autorizuar (emri, mbiemri dhe nënshkrimi) dhe vula

Sqarimi i kompanise nuk eshte i mbeshtetur nga institucionet apo gjykatat e Kosoves por nje dokument i leshuar nga vet kompania Fer- Petroll duke e bere keshtu kete deklarate jovalide.

FER PETROL

N.T FER PETROLL – Tërstenik-Drenas
NUI: 810247967
044/431/851

Datë: 06.12.2021

DEKLARATE NEN BETIM
(ndi kerkesat e pershtatshmerise)

Deklarojm se lenda e cekur ne Qertifikaten e Gjykates me nr 600/16, e drejtorit Mehdi Gjoka nuk ka te bej me qeshtjet te cilat jane te cekura ne piken D) per kryerjen e veprave penale ose civile qe kane te bejne me korrupsion, larjen e parave, dhenien e mitos, apo avantazhe ose aktivitete te ngjashme.

Deklarojm se jemi ne perputhje me permbushjen e kerkesave te pershtatshmerise dhe te cekura ne Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ Për Prokurimin Publik(janar 2021).

N.T Fer Petroll

Sipas fletes se te dhenave te dosjes se tenderit si kriter eshte kerkuar :

1. Inxhinier i diplomuar i Gjeologjisë ose ing.dipl. ndërtimtarisë–drejtimi konstruktiv 5 vite përvojë punë pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku *tri(3) projekte* nga lëmia e kërkuar (sanim të rrëshqitjeve të dheut ,rikonstruktim , ose ndërtim i rrugëve dhe Urave).

2. Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë –drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore- tri(3) vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, apo rikonstruktimit të strukturave në rrugë (ura , nënkalime ose mbikalim). Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëminë e kërkuar

Konzorciumi fitues **nuk ka ofruar nje vendim per udheheqes te punishtes** por vetem nje vendim per menaxher te projektit.

Konzorciumi ka ofruar dokumentet per dy inxhinieret e kompanise Drini Company shpk znj.Zarife Zenelaj dhe z.Ramadan Paqarizi dhe nje vendim per menaxherin e projektit por jo edhe vendim per udheheqesin e Punishtes.

Perderisa znj. Zenelaj ka pervojen e mjaftueshme per te plotesuar njerin nga kriteret e mesiperme, z.Paqarizi nuk i ploteson kriteret meqenese projektet te cilat I ka udhehequr kane te beje me mirembajtje te rrugeve dhe me ndertim te objekteve dhe jo si udheheqes ne projektet e ndertimit apo rikonstruktimit te strukturave ne rruge (ura, nenkalime ose mbikalim).

Perpos dosjes se tenderit Autoriteti kontraktues si dokumentacion shtese ka ofruar listen e pajisjeve dhe specifikacionet teknike ku ne ato specifikacione pershkruhen detyrat e menaxherit te projektit dhe poashtu te udheheqesit te punishtes.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa: *b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.*
d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.
Dëshmia: *b) Vërtetim nga Administrata Tatimore, d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal ose kopje*

Kapaciteti teknik dhe professional

Kërkesa: *1. Inxhinier i diplomuar i Gjeologjisë ose ing.dipl. ndërtimtarisë–drejtimi konstruktiv 5 vite përvojë punë pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri(3) projekte nga lëmia e kërkuar (sanim të rrëshqitjeve të dheut ,rikonstruktim , ose ndërtim i rrugëve dhe Urave). 2. Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë –drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore- tri(3) vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, apo rikonstruktimit të strukturave në rrugë (ura , nënkalime ose mbikalim). Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëminë e kërkuar. Vlera e projekteve të udhëhequra min. ne vlere prej 175,000.00 euro*
Dëshmia: *1.CV- a, të dhënat kryesore që duhet të përmbajë CV-ia, janë -Kualifikimi, përvoja, specializimet, projektet e realizuara në lëmin e kërkuar, etj. Diploma (e noterizuar) , kontrata e punës me ofertuesin (origjinal ose kopje e noterizuar, duke specifikuar titullin e projektit , për të cilin ka lidhë kontratë. Referencat për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit . 2 CV- a, të dhënat*

kryesore që duhet të përmbajë CV-ia, janë -Kualifikimi, përvoja, specializimet, projektet e realizuara në lëmin e kërkuar, etj. Diploma (e noterizuar), Referencat për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit . Kontratë punës (origjinal ose e noterizuar) me punëdhënësin duke specifikuar titullin e projektit , për të cilin ka lidhë kontratë.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit,komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni për vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në raportin e tyre të datës 02.12.2021, nga dhjetë (10) oferta të dorëzuara, nëntë (9) oferta i ka vlerësuar si të përgjegjshme,duke rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE N.T "Fer - Petorll"&"SH.Drini Company" Shpk - Gllogoc me çmim prej 269,996.32 €.

Sa i përket ofertës së grupit të OE ankues N.N"100% Design"Shpk & K.N.P.SH" Papenburg & Adriani Company"Shpk – Skenderaj,nga komisioni i vlerësimit kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin :
Operatori ekonomik ka dështuar të plotësoj kërkesat mbi mundësite teknike dhe profesionale neni 9.1 dhe 9.2 paragrafi 1. Ku kërkohet Menagjer i projektit Inxh i dip.i gjeologjisë ose inxh i dip i ndërtimtarisë –drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.Të ketë dështmi se ka menaxhuar se paku 3 projekte nga lëmia e kërkuar (sanimi i rrëshqitjeve të dheut,rikonstruktim ose ndërtim të rrugëve dhe urave).Si dështmi AK ka kërkuar referenca për punët e mëparme në lëminë e kërkuar nga punedhënsi.OE për menaxherin e projektit Fatmir Tërnava inxh i dip.i ndr.nuk ka arrit të ofroj dështmi se ka ,menaxhuar 3 projekte në leminë e kërkuar(ka ofruar vetëm një kontratë të menaxhuar).
OE nuk ka arrit të plotësij edhe nenin 9.1 dhe 9.2 paragrafi 2, ku kërkohet inxh i dip. i ndër.drejtimi konstruktiv ose infrastruktur rrugore, me tri vite përvojë pas diplomimit si udhëheqës i punishtës në projektet e ndërtimit apo të rikonstruktimit të strukturave në rrugë (ura,nënkalime ose mbikalime).Minimum dy projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.Vlera e projekteve të udhëhequra min në vlerë prej 175,000.00 euro.
OE për udhëheqësin e punishtës Safet Bejta inxh.i dip. i ndr. Nuk ka arrit të ofroj dështmi se ka menaxhuar 2 projekte në lëmin e kërkuar (ka ofruar një aneks kontratë në vlerë prej 18,850.72 euro dhe një kontratë të pa përfunduar).
Operatori Ekonomik ka dështuar të plotësoj edhe kërkesën mbi mundsite teknike dhe profesionale neni 9.1 dhe 9.2 paragrafi 6 ku kërkohet që operatori ekonomik të ketë leje për aktivitete të veqanta, të ketë bazë të licencuar për prodhimin e asfaltit dhe betonit.Si dështmi AK ka kërkuar kopjen e liçencës,lejës për aktivitete të veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.Në rast se OE nuk posedon liçencën,duhet të ofroj Marrëveshje për furnizim me asfalt dhe beton me operator të liçencuar.
OE nuk ka arrit të ofroj dështmi se disponon Bazën e liçencuar për prodhimin e asfaltit dhe Bazën për prodhimin e betonit apo marrëveshje për furnizim me asfalt dhe beton me ndonjë operator ekonomik të liçencuar ashtu siç kërkohet në kërkesat e përcaktuara në Dosje të tenderit dhe Njoftimin e kontratës.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES N.N“100% DESIGN”& K.N.P.SH”PAPENBURG & ARDIANI COMPANY”SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ankues N.N“100% Design”Shpk & K.N.P.SH“ Papenburg & Adriani Company”Shpk,se AK gjatë vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE N.T “Fer - Petorll”&“SH.Drini Company“ Shpk, edhe pse kjo ofertë nuk ka arrit të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, konkretisht vërtetimi i ATK-së për OE “SH.Drini Company “ shpk nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe si e tillë kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka katë mendim.

Ne dosje të tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë është kërkuar që; b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE të rekomanduar për kontratë për anëtarin e konzorciumit “SH.Drini Company “shpk ka dorëzuar vërtetimin tatimor të ATK-së të datës 24.08.2021 në të cilin rezulton se ky OE është në marrëveshje me këste për shlyerjen e borgjeve të mbetura.

Sa i përket rasteve kur një OE është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borgjeve para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës,KRPP në një pyetje të një OE ka dhënë interpretimin se kur një OE ka marrëveshje me ATK-në para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës për shlyerjen e borgjeve të mbetura duhet të vlerësohet si “i pranueshëm”.
Në ketë rast marrëveshja e anëtarit të konzorciumit “SH.Drini Company “shpk me ATK-në është para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës (12.11.2021).

Konisderoj që pretendimi ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk përmbush as kërkesën tjetër të përshtatshmërise,konkretisht vërtetimi i gjykatës për pronarin e anëtarit të konzorciumit të OE N.T “Fer - Petorll” z.Mehdi Gjoka nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne dosje të tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë është kërkuar që; d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë për pronarin e anëtarit të konzorciumit N.T “Fer - Petorll”, z.Mehdi Gjoka ka dorëzuar këtë çertifikatë të gjykatës:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË GLLOGOC
OSNOVNI SUD – OGRANAK

Me kërkesë të MEHDI FERAT GJOKA, Nr.personal 1015546227, i lindur me 02.02.1978,
Na zahtev, Lični Br., Datum rođenja

në TËRSTENIK KK GLLOGOC, me vendbanim në TËRSTENIK, lëshon këtë:
u, sa prebivalištem u, izdaje ovu:

CERTIFIKATË

NGA EVIDENCA E PERSONAVE KUNDËR TË CILËVE ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURA PENALE DHE PERSONAVE TË DËNUAR NGA KJO GJYKATË

UVERENJE

IZ EVIDENCIJE LICA PROTIV KOJIH SE VODI KRIVIČNI POSTUPAK I OSUĐENIH LICA OD OVOG SUDA

Me të cilën konfirmon se kundër parashtruesit të kërkesës, si person fizik MEHDI GJOKA
Ovojom se potvrđuje da se protiv podnosioca zahteva, kao fizičkog lica

Me të cilën konfirmon se kundër parashtruesit të kërkesës, si person juridik
Ovojom se potvrđuje da se protiv podnosioca zahteva, kao pravnog lica

. Nuk është duke u zhvilluar procedurë penale. ☐
Ne vodi krivični postupak.

. Është duke u zhvilluar procedura penale sipas lëndës P.nr. 600/16
Vodi krivični postupak po predmetu K.br.

për veprën penale/*za krivično delo*

nga neni/ *iz člana* I KPRK –së/ *KZRK-a*

. Nuk është i dënuar. ☐
Nije kažnjen.

. Është dënuar me Aktgjykim të formës së prerë nr./*Kažnjen je pravosnažnom presudom br.* 600/16,

datë/*dana*, me dënim/ *kaznom*, në kohëzgjatje prej/ *u trajanju od*

, ose gjobë në shumë prej/ *ili novčanom kaznom u visini od*.

. Dënimi i shqiptuar është ekzekutuar ☐, është ne fazën e ekzekutimit ☐, nuk është ekzekutuar ende ☐.
Izrečena kazna je izvršena, nalazi se u fazi izvršenja, nije izvršena.

ërejtje
I LARTPERMENDURI ËSHT I DENUAR ME DËNIM TE KUSHTËZUAR 6 MUAJ PER 1 VIT DT E PLOTFUQISHMERIS 10.03.2020
Imedba

o Certifikatë mund të përdoret për: TENDER.
o Uverenje se može koristiti u svrhu

N. NR/KR.Br 5460/2021

ata/*Datum* 06.12.2021

REFERENTI: HAMZË ISUFI
Referenti\ Personi\ autorizuar(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi) dhe vula

Bazuar në çertifikatën e gjykatës themelore, dega në Gllogoc,rezulton që z. Mehdi Gjoka ka një Aktgjykim nr.600/16 të

formës së prerë për një dënim të kushtëzuar për 6 muaj.
Lidhur me këtë vendim OE N.T "Fer - Petorll" me datë 06.12.2021 ka dorëzuar një deklaratë nën betim në të cilën ka sqaruar se ky aktgjykim 600/16 nuk ka të bëjë me çështjet të cilat janë cekur në pikën d) të kërkesës së dosjes së tenderit për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

FER PETROL

N.T FER PETROLL – Tërstenik-Drenas
NUI: 810247967
044/431/851

Datë: 06.12.2021

DEKLARATE NEN BETIM
(mbi kerkesat e pershtatshmerise)

Deklarojm se lenda e cekur ne Qertifikaten e Gjykates me nr 600/16, e drejtorit Mehdi Gjoka nuk ka te bej me qeshtjet te cilat jane te cekura ne piken D) per kryerjen e veprave penale ose civile qe kane te bejne me korrupsion, larjen e parave, dhenien e mitos, apo avantazhe ose aktivitete te ngjajshme.

Deklarojm se jemi ne perputhje me permbushjen e kerkesave te pershtatshmerise dhe te cekura ne Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ Për Prokurimin Publik(janar 2021).

N.T Fer Petroll

Eksperti shqyrtues konsideron se deklarata nën betim e dorëzuar nga OE N.T "Fer - Petorll" për pronarin z. Mehdi Gjoka nuk është dokument i mjaftueshëm për të verifikuar nëse ky aktgjykim (600/16) nuk ndërlidhet

me çështjet që janë përcaktuar në kërkesën e dosjes së tenderit.

AK konform nenit 72 të LPP-së është dashur të kërkoj që OE N.T "Fer - Petorll" të dorëzoj aktgjykimin e gjykatës me nr.600/16 që të verifikohet natyra e dënimit se a ndërlidhet me kriteret e kërkuara në kërkesën e dosjes së tenderit,andaj konsideroj që pretendimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Sa i përket pretendimit të OE ankues se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar një vendim për caktimin e udhëheqësit të punishtes por ka ofruar vetëm një vendim për menaxher të projektit, eksperti shqyrtues sqaron se në kërkesat e dosjes së tenderit nuk është përcaktuar në mënyrë specifike që duhet të caktohet udhëheqësi i punishtës.Në dosje të tenderit është kërkuar "Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë –drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore- tri(3) vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit,", që nënkupton që përvoja e punës duhet të jetë si udhëheqës i punishtes dhe nuk është kërkuar vendim për caktimin e udhëheqësit të punishtes, andaj pretendimi ankimor është i pa qëndrueshëm.

Ndërsa lidhur me pretendimin se inxhinieri i ndërtimtarisë i anëtarit të konzorciumit "SH.Drini Company "shpk,z Ramadan Paqarizi nuk plotëson kriteret sepse projektet të cilat i ka udhëhequr kanë të bëjnë më mirëmbajtje të rrugëve dhe ndërtim të objekteve dhe jo siç është përcaktuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE të rekomanduar për kontratë N.T "Fer - Petorll"&"SH.Drini Company" Shpk ka dorëzuar dokumentet për dy inxhinier të ndërtimtarisë Znj,Zarife Zenelaj dhe z.Ramadan Paqarizi.Në dy kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit për inxhinier të ndërtimtarisë ndër të tjera është kërkuar që të ofrohet dëshmi për mënaxhimin e projekteve që lidhet me ndërtimin e rrugëve dhe referencat e ofruara për inxhinierin Ramadan Paqarizi ndërlidhen edhe me projketet e ndërtimit të rrugëve.Konsideroj që referencat e dorëzuara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë për të dy inxhinieret e ndërtimtarisë e përmbushin kërkesën 1 dhe 2 të kapacitetit teknik dhe profesional ,andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se oferta e grupit të OE ankues N.N"100% Design"Shpk & K.N.P.SH" Papenburg & Adriani Company"Shpk – Skenderaj sipas vendimit të Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 06.12.2021 është eleminuar për këto arsye;

Operatori ekonomik ka dështuar të plotësoj kërkesat mbi mundësite teknike dhe profesionale neni 9.1 dhe 9.2 paragrafi 1. Ku kërkohet Menaxher i projektit Inxh i dip.i gjeologjisë ose inxh i dip i ndërtimtarisë –drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.Të ketë dëshmi se ka menaxhuar se paku 3 projekte nga lëmia e kërkuar (sanimi i rrëshqitjeve të dheut,rikonstruktim ose ndërtim të rrugëve dhe urave).Si dëshmi AK ka kërkuar referenca për punët e mëparme në lëminë e kërkuar nga punedhënsi.OE për menaxherin e projektit Fatmir Tërnava inxh i dip.i ndr.nuk ka arrit të ofroj dëshmi se ka ,menaxhuar 3 projekte në leminë e kërkuar(ka ofruar vetëm një kontratë të menaxhuar).

OE nuk ka arrit të plotësoj edhe nenin 9.1 dhe 9.2 paragrafi 2, ku kërkohet inxh i dip. i ndër.drejtimi konstruktiv ose infrastruktur rrugore, me tri vite përvojë pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit apo të rikonstruktimit të strukturave në rrugë (ura,nënkalime ose mbikalime).Minimum dy projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.Vlera e projekteve të udhëhequra min në vlerë prej 175,000.00 euro. OE për udhëheqësin e punishtes Safet Bejta inxh.i dip. i ndr. nuk ka arrit të ofroj dëshmi se ka menaxhuar 2 projekte në lëmin e kërkuar (ka ofruar një aneks kontratë në vlerë prej 18,850.72 euro dhe një kontratë të pa përfunduar).
Operatori Ekonomik ka dështuar të plotësoj edhe kërkesën mbi mundsite teknike dhe profesionale neni 9.1 dhe 9.2 paragrafi 6 ku kërkohet që operatori ekonomik të ketë leje për aktivitete të veqanta, të ketë bazë të licencuar për prodhimin e asfaltit dhe betonit.Si dëshmi AK ka kërkuar kopjen e liçencës,lejës për aktivitete të veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.Në rast se OE nuk posedon liçencën,duhet të ofroj Marrëveshje për furnizim me asfalt dhe beton me operator të liçencuar.
OE nuk ka arrit të ofroj dëshmi se disponon Bazën e liçencuar për prodhimin e asfaltit dhe Bazën për prodhimin e betonit apo marrëveshje për furnizim me asfalt dhe beton me ndonjë operator ekonomik të liçencuar ashtu siç kërkohet në kërkesat e përcaktuara në Dosje të tenderit dhe Njoftimin e kontratës.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE N.N“100% Design”Shpk & K.N.P.SH“ Papenburg & Adriani Company”Shpk – Skenderaj në ankesën e parashtruar në OSHP nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim apo dëshmi lidhur me arsyet e eleminimit të ofertës së tyre.

Konsideroj që AK nuk ka bërë vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit,andaj rekomandoj që të lënda të kthehet në rivlerësim. AK gjatë fazës së rivlerësimit duhet të kërkoj nga OE N.T “Fer - Petorll” të dorëzoj aktgjykimin e gjykatës me nr.600/16.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

ke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si pjesërisht e bazuar**,të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - “MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS”
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - ANKUES N.N“100% DESIGN”& K.N.P.SH”PAPENBURG & ARDIANI COMPANY”SHPK